

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINE KOMBETARE TE USHQIMIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Autoritetin Kombëtare të Ushqimit, me objekt “Për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare”, për periudhën 01.01.2012 deri 31.12.2013, si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së nr.28, datë 31.03.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” i ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 955/7, datë 31.03.2014, dërguar z. Afrim Bakaj, Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtare të Ushqimit, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave sa më poshtë:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI:

1. Nga auditimi është konstatuar se për vitin 2011 ka dalë udhëzim i miratuar nga titullari i AKU “Mbi procedurat e vendosjes se gjobave, evidentimit, administrimit dhe ndjekjes për arkëtim” drejtuar për zbatim Drejtorisë Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Inspektimit, Drejtorisë Shërbimeve të Brendshme, Sektorit të Auditit të Brendshëm, Drejtorive Rajonale. Nga auditimi për vendosjen e gjobave, hedhjen në sistem, kontabilizimet, arkëtimet dhe ndjekja ligjore e tyre, ka rezultuar se ky udhëzim nuk ka gjetur zbatimin e plotë nga strukturat përkatëse.

Ne ligjin nr.9863, datë 28.01.2008” Për ushqimin”si dhe në ligjin e ndryshimit të tij me nr. 74/2013, në nenin 70/4 theksohet : “ Mënyra e vjeljes se gjobave dhe shpërndarja e tyre përcaktohen me vendime të Këshillit të Ministrave me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit. Aktualisht në AKU nuk ka në zbatim asnjë akt nënligjor të propozuar apo të miratuar në këtë drejtim. **Për këtë është rekomanduar që:**

- Në zbatim të ligjit nr. 9863, date 28.01.2008” Për ushqimin”të ndryshuar me ligji nr. 74/2013 nga AKU dhe MBZHRAU të hartohet vendimi dhe t’i propozohet Këshillit të Ministrave “ Mënyra e vjeljes se gjobave dhe shpërndarja e tyre”.

- Të verifikohen aktet e lënies së gjobave nga çdo DRAKU si dhe nga AKU hedhja e plotë e tyre në sistemin AKU – net për vitin 2012- 2013, si dhe të kryhet kontabilizimi i gjobave të pa arkëtuara për vitet e mësipërme.

Brenda 6 mujorit të parë 2014

2. Nga auditimi është konstatuar se Rregullorja e Brendshme ekzistuese është e miratuar nga Titullari i institucionit, por jo nga Bordi Drejtues i tij dhe për rrjedhojë, as nga Ministri i Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, në kundërshtim me kreu II, pika 5 gërma’ a” të VKM nr. 1081, datë 21.10.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”. Rregullorja e Brendshme aktuale, e miratuar nga Titullari i AKU, sipas të drejtave që i ka dhënë ligji, nuk i përshtatet korrektësisht strukturës organike të miratuar në gusht të vitit 2013 si dhe asaj aktual. **Për këtë është rekomanduar që:**

-Të bëhen përmirësime për përshtatjen e kësaj rregullore, në përputhje me organigramën e institucionit, ku këto ndryshime të shoqerohen me plotësimin e saj me rregullat dhe detyrat për çdo pozicion pune, sipas përgjegjësi, referuar ligjit për MFK si dhe akteve në funksion të tij. Kjo rregullore të marrë miratimet përkatëse sipas përcaktimit në aktet ligjore.

Menjëherë

3. Referuar konstatimit nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të mëparshme se nuk ka qenë pjesë e plan veprimit si dhe nuk është zbatuar rekomandimi për përcaktimin e standardeve ushqimore të çdo produkti në veçanti dhe për nën produktet e tyre, si dhe rishikimi i udhëzimit nr. 8, datë 08.05.2007 “Mbi tarifatat e të ardhurave detyesore, të aplikuara nga institucionet e vartësisë së Ministrisë Bujqësisë” si një udhëzim që ka dalë para krijimit të AKU, ***e ripërsërisim këtë rekomandim si më poshtë vijon:***

“Nga auditimi i kryer për kryerjen e analizave të produkteve ushqimore për të gjithë treguesit fiziko- kimikë të çdo produkti ushqimor dhe garantimin e tyre për konsum publik, sipas standardeve të miratuara, u konstatua se AKU dispononte standarde të miratuara në vitin 1989 dhe jo standarde konform treguesve që shoqërojnë produktet e importuara nga vendet e Komunitetit Evropian. Në udhëzimit nr. 8, datë 08.05.2007 “Mbi tarifatat e të ardhurave detyesore, të aplikuara nga institucionet e vartësisë së Ministrisë Bujqësisë”, treguesit cilësorë të produkteve janë të pandarë nga nënproduktet e tyre, duke sjellë si pasojë vështirësi në përcaktimin e treguesve të produktit nga nënproduktet e tyre, të cilat lidhen edhe me tarifatat që arkëtohen për çdo tregues të veçantë që analizohet. **Për këtë është rekomanduar që:**

-MBUMK dhe Drejtoria e Përgjithshme e AKU, të marrë masa për përcaktimin e standardeve ushqimore të çdo produkti në veçanti dhe për nën produktet e tyre, konform standardeve të Komunitetit Evropian që shoqërojnë produktet që importohen, si dhe përcaktimin e tarifave përkatëse të tyre.”

Brenda 9 mujorit të vitit 2014

B. MASA ORGANIZATIVE

1.Për gjithë periudhën e auditimit, ky institucion, magazinën e ka të organizuar *pa magazinier në organikë*, duke e kryer këtë funksion një punonjës i ngarkuar nga Drejtori i Përgjithshëm, në kundërshtim kjo me udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, duke administruar magazinën pa dokumente të rregullta justifikuese. **Për këtë është rekomanduar që:**

-Emërimi i një magazinieri në organikë, në mënyrë që administrimi i aktiveve të trupëzuara dhe aktiveve qarkulluese, por edhe i materialeve të jetë sa më i saktë dhe në përputhje me dispozitat ligjore.

Menjëherë

2. Nga auditimi u konstatua pamjaftueshmëri e fondeve për blerjen e reagentëve, si dhe mungesa e programimit të fondeve për pajisje për laboratorët, gjatë vitit 2013, në një kohë që një pjesë e mirë e pajisjeve janë me defekte apo të amortizuara si rezultat i vjetërsisë së viteve në punë. Gjithashtu referuar faktit të mungesës së informimit të strukturave përkatëse përgjegjëse, me udhëzimet e Ministrisë së Financave “Për përgatitjen e programeve

buxhetore afatmesme dhe vjetore” për procesin e kryerjes së këtij programimi dhe kohën e tij, si dhe mungesën e nxjerrjes së udhëzimeve të brendshme për këtë proces, **është rekomanduar që:**

- Nga Drejtoria e Përgjithshme e AKU në çdo programim të fondeve buxhetore afatmesme dhe vjetore, të hartohen udhëzimet dhe urdhrat përkatës në zbatim të udhëzimeve vjetore të nxjerra nga Ministria e Financave për këtë qëllim, si dhe të luajë rolin e asistencës për të gjitha drejtoritë rajonale.

- Në planifikimin e nevojave për vitin pasardhës, të kihet në konsideratë nevojat reale për reagentë e pajisje laboratorike apo pajisje për inspektorët e kontrollin. Për këto nevoja, kur tejkalojnë tavanet vjetore të fondeve të përcaktuara për AKU, të plotësohen formularët shtesë të fondeve, sipas procedurave të përcaktuara në udhëzimet e MF, me qëllim realizimin e objektivave të programit.

Në planifikimin e radhës e në vazhdimësi

3. Referuar konstatimit të auditimit se, në kryerjen e pagesave të vendimeve gjyqësore rezultuan:

a. Në të gjitha rastet e shlyerjes së detyrimeve nga vendimet gjyqësore, nuk janë nxjerrë përgjegjësitë administrative për personat përgjegjës, përpara kryerjes së likuidimeve të vendimeve gjyqësore;

b. Nuk ka asnjë gjurmë të përpjekjeve për grafikim të shlyerjes së detyrimeve për asnjë nga rastet e pagesave të kryera në mënyrë të plotë apo të pjesshme. **Për këtë është rekomanduar që:**

- Në çdo vit buxhetor nga secili institucion i vartësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e AKU, të parashikohen fondet e nevojshme për likuidim, bazuar në vendimet për ekzekutim.

- Nëpunësi autorizues dhe ai zbatues duhet të grafikojnë shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i vendimeve gjyqësore dhe të mos lejojnë kalimin për pagesë, të vendimeve gjyqësore, mbi bazën e dokumentacionit fotokopje.

- Analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësisë për dëmin ekonomik të krijuar si rezultat i pagesave të kryera nga zbatimi i vendimeve gjyqësore në çdo rast.

Menjëherë

4. Në urdhër shpenzimet e kryera gjatë periudhës së auditimit, u konstatuan mangësi në dokumentet justifikuese të tyre, si:

a. Të gjitha ofertat që shoqërojnë urdhrat e shpenzimeve për blerjet e vogla gjatë vitit 2012, janë pa data;

b. Ka diferenca në kohë midis urdhër prokurimit dhe proces verbaleve apo formularëve (3 & 4);

c. Likuidimi për riparimin e makinave dhe blerjen e baterive është realizuar pa bërë më parë një akt vlerësimi të gjendjes teknike;

d. Likuidimi i shërbimit postar është bërë gjithë vitin 2012 dhe 2013, vetëm me faturën tatimore, pa një akt rakordimi për shërbimet e kryera midis palëve për çdo muaj, në kundërshtim me ligjin nr.10290, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, nenet 19, 25 dhe 26 të tij. **Për këtë është rekomanduar që:**

-Në shpenzimet e realizuara për “blerjet e vogla” dhe për “shërbimet e kryera nga të tretët”, dokumentet shoqëruese si ofertat, proces verbalet nr. 3 & 4, etj., të miratohen dhe regjistrohen në kontabilitet me të gjitha karakteret e domosdoshme të formateve dhe akteve ligjore .

-Nga struktura e protokollit të AKU, të nxirren shifrat mujore të shërbimeve postare, në mënyrë që kjo shifër të rakordohet me numrin e shërbimeve të vendosura në faturën tatimore të paraqitur për likuidim. Ky rakordim të realizohet për çdo likuidim.

Vazhdimisht

5. Nga auditimi u konstatua se AKU, ka të lidhur kontratë me Albtelekom për telefoninë fikse, ku sipas konstatimit në pagesat mujore të shërbimit për periudhën e auditimit, 2-3 numra janë të papërdorur dhe për to është paguar tarifa e shërbimit, si dhe referuar faktit që për një pjesë të numrave të përdorur ishin të lejuara shërbimet urbane, ndër/urbane, mobile, ndërkombëtare, me qëllim të eliminimit të shpenzimeve jo efektive. **Për këtë është rekomanduar që:**

-Rishikimi dhe përcaktimi i numrit të domosdoshëm të telefonave fiks në përdorim të AKU dhe përcaktimi i llojit të shërbimit,(urbane, ndër/urbane, mobile, ndërkombëtare), vetëm për ato numra që paraqesin domosdoshmëri.

Menjëherë

6. Nga auditimi u konstatua se AKU- ja për vitet 2012-2013 ka kryer abonime në 23 gazeta e revista periodike me një kosto të konsiderueshme në vit, në një kohë që funksionon sistemi elektronik i informimit për shtypin e shkruar në shumicën e tyre, për një menaxhim më të mirë të fondeve buxhetore. **Për këtë është rekomanduar që:**

- Përzgjedhjen e shtypit të shkruar në funksion të realizimit të misionit dhe objektivave të AKU, duke e mbajtur këtë zë të shpenzimeve në nivele të pranueshme.

Menjëherë

7. Nga auditimi mbajtjes së kontabilitetit, përpilimi i bilancit kontabël për aparatën e këtij institucioni rezultoi:

Ditari i veprimeve të hyrjeve dhe daljeve të magazinës regjistrohej nga specialistja e financës me një ditar të veçantë, të hartuar në excel, ku në fund të çdo muaji nxirret gjendja e llogarive që debitohen dhe kreditohen, por edhe nga Përgjegjësi i Sektorit të Financës, duke bërë regjistrimin e hyrjeve dhe daljeve me programin “Financës 5” për vitin 2012 dhe me ditar në Excel, për vitin 2013. Gjithashtu u konstatua se për të dy format e regjistrimit dhe kontabilizimit të daljeve për llogaritë inventariale, nuk është bërë specifikimi “në përdorim”.

Për këtë është rekomanduar që:

- Ndarjen e detyrave në Sektorin e Buxhet Financës dhe përcaktimin e qartë të detyrave për kontabilizimin e hyrje daljeve të magazinës, të pagave, urdhër shpenzimeve, veprimet e ndryshme, deri tek nxjerrja e bilancit kontabël, në përputhje me standardet e pranuar për mbajtjen e kontabilitetit, pasqyrave financiare dhe menaxhimit financiar.

- Kontabilizimi i daljeve të: “makineri e pajisje” (llogaria 214), “mjete transporti” (llogaria 215), “inventar ekonomik” (llogaria 218) dhe “objekte inventari” (llogaria 32), duhet të

regjistrohen në ditarët kontabël, duke përdorur këto llogari me *përshkrimin, apo fraksionin “në përdorim”*, në mënyre që gjendja e tyre kontabël, të përputhet me gjendjen e tyre fizike.

Menjëherë

8. Nga auditimi i përmbledhëses së llogarive vjetore për gjithë institucionin rezultoi:

a. Mbyllja e Pasqyrave Financiare dhe nxjerrja e bilancit përmbledhës të vitit 2012, për të 12 Drejtoritë Rajonale dhe Aparatin e Drejtorisë së Përgjithshme të AKU, është përpiluar, por nuk i është dërguar Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit me shpresë, së bashku me shpjeguesin e pozicioneve të llogarive (relacionin);

b. Drejtoria Rajonale Gjirokastrë, e ka dorëzuar bilancin pa relacion shpjegues dhe me shumë korrigjime dhe Drejtoria Rajonale Fier, e ka dorëzuar atë, pa plotësuar pyetësorin bashkëlidhur formatit të tij;

c. Në përmbledhësen e 13 llogarive vjetore të institucionit për vitin 2012, gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, është 2,857,150 lekë, kundrejt vlerës prej 11,336,850 lekë, që është gjendja e kësaj llogarie për vitin 2011. Ky ndryshim kaq i madh në vlerë, prej 8,479,700 lekë, nuk kishte shpjegimin as në relacionin e përmbledhës së llogarive vjetore, por as në relacionet e llogarive vjetore të 4 Drejtorive Rajonale, që përbëjnë, këtë diferencë, si Korça për 1,527,000 lekë, nga 1,016,850 lekë në vitin 2011; Fieri për 200,150 lekë, nga 9,820,000 lekë në vitin 2011; Elbasani për 1,100,000 lekë, nga 500,000 lekë në vitin 2011 dhe Shkodra për 30,000 lekë, nga zero lekë në vitin 2011. **Për këtë është rekomanduar që:**

- Marrjen e masave ndëshkuese për financierët e Drejtorive Rajonale, për të cilët konstatohet dorëzimi i llogarive vjetore me pasaktësi, korrigjime, apo mungesa në shpjegimet analitike të llogarive dhe për të gjitha postet e pasqyrës financiare vjetore.

- Të bëhet analiza e plotë e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, në vlerë 2,857,150 lekë, shume e 4 drejtorive Rajonale, rezultuar dhe e pa shpjeguar në bilancin përmbledhës të AKU për vitin 2012, kundrejt 11,336,850 lekë, që rezultonte kjo llogari për vitin 2011, arsyet e një ndryshimi të tillë nga një vit më parë dhe në qoftë se rezultojnë shifra të pa shpjegueshme në këtë ndryshim, të bëhet përcaktimi i përgjegjësive.

Menjëherë

9. Gjatë auditimit të përdorimit të mjeteve të transportit, rezultoi:

a. Drejtoria e Përgjithshme e AKU, ka në inventar dhe në përdorim për vitin 2012, 4 mjete transporti dhe për vitin 2013, 5 mjete transporti. Për shkak të volumit të madh të punës inspektuese, me urdhër të titullarit dhe me kërkesë të Drejtorisë Rajonale Tiranë, një automjet i ka kaluar për përdorim kësaj Drejtorie Rajonale, duke përcaktuar në këtë urdhër që, furnizimi me karburant dhe shërbimet e tjera do të mbulohen nga Drejtoria e Përgjithshme e AKU. Për këtë transferim, nuk ka asnjë miratim nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, apo edhe nga Ministria e Financave, për të justifikuar ligjshmërinë, domosdoshmërinë e këtij transferimi, apo përdorimin e fondeve për karburant e riparime të Drejtorisë së Përgjithshme të AKU, për llogari të Drejtorisë Rajonale Tiranë, në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me ligjin nr. 10160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë”, ku në nenin 6 të tij citohet “Numri i automjeteve në dispozicion, për çdo ministri apo njësi varësie, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave”;

b. Nga auditimi i përdorimit të mjeteve të transportit, janë hartuar proces verbale për llogaritjen e normës së harxhimit të karburantit për 100/km, vetëm për 2 automjete, nga 5 automjete që ka në përdorim institucioni. Gjithashtu nuk ka të dhëna të plota për automjetet, të cilat janë transferuar nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe si rrjedhojë, nuk kanë të evidentuara dhe transferuara kilometrat e përshkruara, normat e amortizimit si dhe kanë rezultuar mangësi në plotësimin e “Kërkesës për Shërbim”, të cilat nuk janë të firmosura nga Drejtori i Drejtorisë përkatëse. **Për këtë është rekomanduar që:**

- AKU në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, të ndërmarrë një studim për hartimin e procedurave të veçanta dhe domosdoshmërinë në përcaktimin e mjeteve të transportit për mbulimin e punës inspektuese për të gjithë Drejtoritë Rajonale, në mënyrë që përdorimi i tyre të jetë në përputhje me dispozitat ligjore, i shpërndarë në bazë të nevojave, subjekteve, terreneve që mbulon ky institucion dhe njësitë vartëse të tij dhe t’ja paraqesë Këshillit të Ministrave për miratim.
- Ngritjen nga Titullari dhe struktura drejtuese të Shërbimit të Brendshëm të komisionit të vlerësimit të mjeteve, komisionit të llogaritjes së harxhimit të karburantit për 100/km, apo të miratimit të formateve “Kërkesë për shërbim” dhe “urdhrit apo autorizimit për shërbim”, në mënyrë të tillë që përdorimi i tyre të jetë i justifikuar dhe në përputhje me dispozitat ligjore.

Menjëherë

10. Nga auditimi i funksionimit dhe vlerësimit të Auditimit të Brendshëm, rezultoi se:

a. Nuk është shfrytëzuar me efektivitet koha e auditimit në subjektet e audituara. Gjithashtu nuk është bërë një angazhim i arsyeshëm i burimeve njerëzore, sepse pothuajse të gjitha auditimet, janë kryer nga dy auditues nga tre që ka sektori i auditimit.

b. Në AKU janë realizuar auditime të përbashkëta me auditues të Sektorit të Auditimit të Brendshëm dhe inspektorë të Drejtorisë së Inspektimit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo shtazore dhe Operatorëve të Biznesit. Detyrat e gjithsecilit në përpilimin e këtyre auditim-inspektimeve janë me ligjet përkatëse të auditimit të brendshëm dhe atij të inspektimit.

c. Në disa dosje auditimi, ka mospërputhje të afateve të auditimit, njoftimit të fillimit të angazhimit dhe takimit fillestar, me justifikimin se janë marrë angazhime tematike (të qëllimit) nga Drejtori i Përgjithshëm. Gjithashtu në disa dosje auditimi, ka vonesa nga subjektet e audituara në dërgimin e observacioneve, ose mungojnë “planet e veprimit” të subjekteve të audituara, në kundërshtim me Manualin e Auditimit të Brendshëm dhe udhëzimin nr. 12, datë 05.06.2012 “Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik”, aneksi nr. 8 “Për përfundimin e angazhimit të auditimit”.

Për këtë është rekomanduar që:

- Të planifikohet nga Titullari i institucionit dhe strukturat e auditimit të brendshëm më shumë kohë audituese në subjektet e audituara, duke bërë një angazhim në subjekt për numrin e plotë të audituesve në përbërje të sektorit, në përputhje me Manualin e Auditimit të Brendshëm dhe udhëzimin nr. 12, datë 05.06.2012 “Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik”.

-Nga Titullari i institucionit dhe strukturat drejtuese të auditimit dhe inspektimit, planifikimi, realizimi dhe raportimi i auditimeve dhe inspektimeve, të bëhen të ndara dhe në përputhje

me legjislacionin, në mënyrë që gjithsecili të plotësojë angazhimet e veta, në funksion të plotësimin e objektivave të secilës strukturë.

- Nga Titullari i institucionit dhe strukturat drejtuese audituese, të bëhet përcaktimi i saktë i kohës së auditimit për auditimet tematike (të qëllimit).

- Për rekomandimet e lëna nga auditimi, të ndërmerren masa ndëshkuese për strukturat drejtuese të institucioneve të varësisë, të cilat nuk zbatojnë rekomandimet e miratuara nga Titullari i AKU.

Vazhdimisht

11. Referuar auditimit të dosjeve të auditimit gjatë viteve 2012 dhe 2013, ka rezultuar se nuk janë kryer trajnime të detyrueshme, që sipas normave të Manualit të Auditimit janë 50 orë në vit. **Për këtë është rekomanduar që:**

Të bashkërendohen veprimet midis Sektorit të Auditimit të Brendshëm dhe Njesisë Qendrore të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministri të Financave, për programimin e trajnimeve të detyruara për auditët mbi Manualin e ri dhe procesin e formimit profesional, përditësimin e njohurive dhe edukimin e përditësuar. Prioritet të marrin auditimet e fushave të reja me risk (si auditime të performancës dhe të TI, etj), si auditime të rëndësishme për funksionet që kryen AKU. Gjithashtu nga kjo drejtori mund të organizohen dhe trajnime të brendshme për të përgjithësuar gjetjet fenomen dhe eksperiencën personale të auditeve.

Vazhdimisht

12. Të rritet efienca e sistemit mbi kontrollin e cilësisë, rishikimin dhe vlerësimin e dosjeve të auditimit nga Sektori i Auditimit të Brendshëm, me qëllim që procedurat e rishikimit të cilësisë të mos mbeten thjeshtë një proces formal, por të shërbejë si një filtër dhe si vlerë e shtuar organizative për përmirësimin e cilësisë së auditimit. Gjurmët e auditimit për këtë proces të jenë pjesë e dosjes së auditimit për çdo proces auditimi.

Vazhdimisht

13. Nga Sektori i Auditimit të Brendshëm në procesin e lënies së rekomandimeve në subjektet e audituara të përcaktohet qartë detyrimi për kryerjen e veprimeve kontabël si dhe ndjekjen e të gjitha rrugëve ligjore për rastet e rekomandimeve për shpërblimin e dëmit.

Vazhdimisht

14. Të kryhet arkivimi i dosjeve të auditimit të brendshëm në arshivën e institucionit, pasi të jetë inventarizuar çdo informacion përbërës dhe sipas të gjithë kërkesave të ligjit Nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, Manualit të Auditimit të Brendshëm dhe Normave tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor.

Vazhdimisht

15. Nga auditimi u konstatua se në AKU nuk kishte rregulla të brendshme të miratuara për gjurmët e auditimit, për procedurat standarde të përdorimit të fondeve buxhetore për shpenzimet për paga, operative sipas llojit, për administrimin e asetëve dhe materialeve të institucionit si dhe të rregullave të procedurave të prokurimit publik, me synim që të sigurohet se të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë që u mundëson audituesve të brendshëm e të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrolli. **Për këtë është rekomanduar që:**

Nga N/A dhe Titullari i institucionit, ku aktualisht në AKU Nëpunësi Autorizues është dhe Titullar institucioni, në zbatim të nenit 9, pika 2 dhe nenit 16, pika 2, të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, të hartohen dhe të miratohen rregullat për gjurmët e auditimit, për procedurat standarde të shpenzimeve, sipas udhëzimeve të nxjerra në zbatim të Ligjit.

Menjëherë

16. Nga auditimi i dosjeve të prokurimit u konstatua:

a. Regjistri i parashikimeve të prokurimit dhe regjistri i realizimit të prokurimeve për periudhën objekt auditimi, nuk ishin të plotësuar në mënyrë të rregullt konform rregullave në fuqi për objektet e prokurimit “Shërbimi i sigurimit dhe ruajtjes se objektit”.

b. Gjithashtu fondi limit për këto objekte prokurimi “ Shërbimi i sigurimit dhe ruajtjes se objektit”, nuk ishte llogaritur mbi bazën vlerës së të gjithë elementeve që përbejnë koston për një roje objekti. Mungojnë në to elementet për shpenzimet si: ditët e punës gjithsej për çdo roje për periudhën e shërbimit, shpenzimet për veshmbathjen, shërbimin ndërlidhës, shpenzimet për mbajtjen e armës me gjithë fishekët, këto të vlerësuara sipas legjislacionit në fuqi. **Për këtë është rekomanduar që:**

- Të hartohen për periudhat në vazhdim regjistri i parashikimeve dhe regjistri i realizimit të prokurimeve, me të gjitha të dhënat e nevojshme të përcaktuara në dokumentet standard, duke pasqyruar hap pas hapi çdo ndryshim të fondeve dhe objekteve

-Për proceset e prokurimit në vazhdim për “ Shërbimin e sigurimit dhe ruajtjes së objektit” të behet llogaritja e vlerës së fondit limit, duke ju përmbajtur me rigorozitet përcaktimeve ligjore mbi pagat dhe shtesat mbi pagën e punonjësve të shërbimit. Ky kriter të kihet parasysh në vlerësimin e ofertave të paraqitura.

Vazhdimisht

17. Duke marrë shkas nga vlera e ulet e ofertave të paraqitura dhe të shpallura fituese nga subjektet që kryejnë “Shërbimin e sigurimit dhe ruajtjes se objektit” në këtë institucion, të cilat llogarisin jo korrektësisht pagesat dhe shtesat mbi pagën e punonjësve të shërbimit, duke mos plotësuar përcaktimet ligjore, **është rekomanduar që:**

-Për kontratat që do të lidhen në vazhdim të vendoset klauzolë, që pagesa e subjektit duhet të kryhet vetëm pasi subjekti të ketë paraqitur lis-pagesat e firmosura nga punonjësit si dhe derdhjen e kontributeve për secilin punonjës të paguar për periudhën e kontraktuar.

Vazhdimisht

18. Nga auditimi u konstatua se mungon dokumentacioni argumentues i llogaritjes së fondit limit në dosjen e prokurimit në kundërshtim kjo me DST. **Për këtë është rekomanduar që:**

-Për prokurimet në vazhdim të plotësohen dosjet e prokurimit me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për llogaritjen e fondit limit dhe të kostos për vlerat limit të kontratës publike.

Vazhdimisht

19. Nga auditimi u konstatuan shkelje sa i takon kompletimit të dosjeve të prokurimit, inventarizimit dhe protokollimit në kohë të tyre. **Për këtë është rekomanduar që:**

-Të kryhet inventarizimi dhe arkivimi i dosjeve të prokurimeve publike që nga vitit 2012 e në vazhdim, me te gjitha dokumentet duke përfshirë dhe raportin e realizimin e kontratës.

Menjëherë

20. Nga auditimi rezultoi se, pronat e paluajtshme në administrim të AKU referuar vendimit të KM nr. 820, datë 13.10.2010 dhe urdhrin të Ministrit të BZHRAU, nuk janë regjistruar në Regjistrin e Pronave të Paluajtshme, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme". **Për këtë është rekomanduar që:**

-Të përgatitet dokumentacioni ligjor i pronësisë për objektet që i janë vënë në dispozicion nga MBZHRAU në zbatim të vendimit të KM, Drejtorisë së Përgjithshme të AKU dhe njësisë të vartësisë dhe të kryhet regjistrimi Pronave të Paluajtshme.

Menjëherë

21. Gjatë auditimit të vlerësimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, u konstatua se:

a. Nga strukturat drejtuese, nuk është hartuar dhe miratuar "Deklarata e Misionit" të AKU dhe nuk ka një Strategji, e cila të përmbajë objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit, për arritjen e qëllimeve strategjike, me persona konkretë, përgjegjës për realizimin e tyre;

b. Nuk është krijuar Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS), sipas kërkesave të Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit, nuk është caktuar Koordinatori i Riskut dhe Strategjia e Menaxhimit të Riskut, për identifikimin, analizimin dhe kontrollin e risqeve që mund të vënë në rrezik përmbushjen e objektiveve të AKU, të përcaktuara gjatë planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe vjetor. **Për këtë është rekomanduar që:**

Mbështetur në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Titullari i institucionit me strukturat e tij, të hartojë "Deklaratën e misionit", strategjinë, objektivat dhe planet e veprimit për arritjen e qëllimeve, duke përcaktuar personat përgjegjës për këtë qëllim, të krijojë dhe miratojë Grupin për Menaxhimin Strategjik (GMS), Koordinatorin e Riskut dhe Strategjinë e Menaxhimit të Riskut.

Vazhdimisht

22. Gjatë auditimit të vlerësimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, u konstatua se:

a. Nuk monitorohen nga Titullari dhe strukturat e tij, njësitë në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të AKU, mbi efektivitetin e të gjitha sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të këtyre njësisë;

b. Vlerësimet vjetore të punonjësve, për të gjithë periudhën e audituar, nuk janë bërë konform legjislacionit në fuqi dhe jo nga të gjitha strukturat dhe për të gjithë punonjësit e këtij institucioni. **Për këtë është rekomanduar që:**

- Të monitorohen nga Titullari dhe strukturat e tij, efektiviteti i të gjitha sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të institucioneve të varësisë dhe të raportohet për efektivitetin e këtij sistemi.

- Çdo strukturë në përbërje të këtij institucioni, të bëjë vlerësimet vjetore të punonjësve, t'i miratojë tek titullari dhe një kopje të këtyre vlerësimeve t'ja dërgojë Departamentit të

Administratës Publike, në bazë të kriterëve të miratuara, në përputhje me ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

Vazhdimisht

23. Referuar faktit se në PIK (pikat e inspektimit kufitar) inspektorët e kontrollit për ditët e shtuna dhe të diela, duhet të pengojnë biznesin për efekte të mos funksionimit të Bankave të nivelit të dytë “ për kryerjen e pagesave për tarifatat e shërbimit “ sipas udhëzimit 8 të tarifave, me qëllim dhe *të eliminimit të hapësirave të pagesave disa fish në dorë të këtyre tarifave,* për efekte të mos pengimit për arsytet e mësipërme nga Inspektorët e PIK, sa trajtuar në faqet 138-152 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **është rekomanduar që:**

-Të udhëzohen PIK nga AKU dhe DRAKU në qarqe, që në rastet e ditëve të shtuna e të diela si dhe në rastet e festave zyrtare të kryhet arkëtimi me mandat arkëtim deri në limitet e përcaktuara nga MF në udhëzimin për zbatimin e buxhetit. Për këtë të përcaktohen rregulla specifike për ruajtjen administrimin dhe afatet e derdhjes në thesar të shumave përkatëse të arkëtuara si dhe rakordimin e tyre me zyrat e financave.

Menjëherë

24. Nisur nga konstatimi statistikor (referuar raporteve apo rezultateve të auditimit të brendshëm të AKU) i numrit më të vogël të analizave autokontroll (të kryera nga biznesi prodhues për prodhimin e tyre), në krahasim me numrin e kontrolleve zyrtare (të rezultuara gjatë inspektimeve të kryera nga inspektorët në këto biznese prodhuese për produktet e dyshuara), në një kohë që numri i autokontrolleve, referuar numrit të bizneseve prodhuese në një qark duhet të ishte në nivelet më të larta dhe për rrjedhojë do të rritej niveli i garancisë së produkteve të prodhuara, dhe njëkohësisht niveli i të ardhurave për buxhetin e shtetit, **është rekomanduar që:**

-Nga Drejtoria e Vlerësimit dhe Komunikimit të Riskut të konsiderohet dhe të merret në vlerësim risku, kryerja e numrit të nevojshëm të analizave autokontroll nga subjektet prodhuese .

- Drejtoria e Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Inspektimit në bashkëpunim me DRAKU –ut në Qarqe të ndërtojnë procedura inspektimi (që të jenë pjesë e dokumenteve standarde të inspektimit, në fuqi) të identifikimit dhe raportimit të procesit të kryerjes së analizave autokontroll, për çdo prodhim të realizuar nga biznesi prodhues .

Menjëherë

25. Referuar përgjigjeve të dhëna nga Drejtoria e Vlerësimit dhe Komunikimit të Riskut, ku ka rezultuar se shumë biznese sjellin etiketa për notifikim, kur të dhënat mbi standardin e paraqitur të produktit nuk janë konform standardeve në fuqi (standardi ka ndryshuar dhe biznesi nuk ka informim për këtë). Gjithashtu referuar informacionit të dhënë nga *Spektori i Sistemit të Informimit të Shpejte dhe Mbikëqyrjes së Tregut,* të nevojës së rezultuar për plotësimin e të dhënave të domosdoshme që përmban një etikete për notifikim (përcaktim ligjor) me të dhëna shtese, të cilat sipas përcaktimit ligjor janë fakultative për biznesin, por që aktualisht janë domosdoshmëri për mbrojtjen e disa grupeve të veçanta të popullatës me probleme shëndetësore, dhe me synimin e rritjes së sigurisë ushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorit, **është rekomanduar që:**

-Marrja e masave nga strukturat përkatëse të AKU që të përcaktohet si detyrim për biznesin, futja e të dhënave në etiketat për notifikim të elementeve shtesë përbërës së produktit dhe përqindjeve të tyre në ato raste kur kjo paraqet domosdoshmëri në mbrojtjen e grup konsumatoreve me probleme shëndetësore.

-Ndërtimi i procedurave të suksesshme të informimit të biznesit me ndryshimet e standardeve të produktit, referuar standardeve të miratuara ndërkombëtare, si dhe procedurave të garantuara të kontrollit të analizave për produktin për të cilin kërkohet etiketa të notifikohet.(ndryshimin e procedurave aktuale).

Menjëherë

C. MASA SHPËRBLIM DËMI

1. Të ndiqen të gjitha rrugët ligjore (nxirret urdhri përkatës) për shpërblimin e dëmit ekonomik, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhen ndalesat sa më poshtë vijon :

a. Shpërblimin për shumën prej 52.8 Euro ose prej 7,382 lekë shumë për arkëtim nga **përfituesi** [REDAKTUAR] për pagesat e taksisë të cilat janë jo sipas dokumentacionit konform ligjit, pasi kuponi i taksisë në shumën 45 euro për datën 13.02.2013, është një fature pa vule dhe firmë të atij që e ka lëshuar, kurse kuponi i taksisë për datën 17.02.2013 në shumën 7.8 euro është një kupon i rregullt, por i takon datës 17.02.2013, date që është jashtë përcaktimit të urdhrorit të ministrisë me nr. 37, datë 8.02.2013, ku nisja do të bëhet për udhëtimin në Bruksel me datën 13.02.2013 dhe kthimi me datën 15.02.2013 (mbajtur akt i datës 14.02.2014).

Menjëherë

b. Nxjerrjen e përgjegjësisë nga Nëpunësi Autorizues, për pagesën e gjobës në shumën 8,335 lekë për Bashkinë Tiranë, sipas Urdhër shpenzimi nr. 66, datë 11.06.2013, si rezultat i pagesave me vonesë të taksave të Bashkisë për vitin 2010,2011,2012, detyrim i AKU dhe arkëtimin e shumës së mësipërme nga punonjësit përgjegjës (mbajtur akt i datës 14.02.2014).

Menjëherë

c. Kryerjen e rakordimeve dhe të pagesave për kamat vonesë me CEZ – Shpërndarje- sha dhe Ujësjiellës Kanalizime Tiranë për kamat vonesat e vendosura si pasojë e pagesave me vonesë të faturave të energjisë elektrike për muajt Mars, Prill,Qershor, Shtator dhe faturën e ujit për muajin Shtator për vitin 2013. Nxjerrjen e përgjegjësisë dhe arkëtimin e shumave nga punonjësit përgjegjës (mbajtur akt i datës 14.02.2014).

Menjëherë

d. Të ndiqen të gjitha rrugët ligjore (nxirret urdhri përkatës) për shpërblimin dëmi financiar, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhen ndalesat për 290 litra karburant të pa justifikuar me dokumentacionin justifikues, në vlerë 54,100 lekë, për punonjësit e mëposhtëm:

- [REDAKTUAR], për 12,782 lekë;
- [REDAKTUAR], për 3,318 lekë;
- [REDAKTUAR], për 38,000 lekë.

(mbajtur procesverbal me nr.protokolli 251 i datës 14.02.2014).

Menjëherë

2. Te ndiqen të gjitha rrugët ligjore (nxirret urdhri përkatës) për shpërblimin e dëmit ekonomik nga detyrimet e konstatuara nga auditimi në shumën 147 432 lekë që kanë subjektet ndaj Autoritetit Kontraktore Drejtorisë Përgjithshme të AKU dhe Drejtorive Rajonale të AKU-ve dhe që rezultojnë nga zbatimi i kontratave për “ Shërbimin e sigurimit dhe ruajtjes së objektit”, si me poshtë:

- Arkëtimin e shumës **3 376 lekë** nga subjekti [REDAKTUAR] paguar me tepër për kontratën shtesë Nr. [REDAKTUAR], datë [REDAKTUAR] për “Shërbimi i sigurimit dhe ruajtjes së objektit”.

-Arkëtimin e shumës **10 498 lekë** nga shoqëria [REDAKTUAR] paguar me tepër për kontratën Nr. [REDAKTUAR], datë [REDAKTUAR] “ Shërbimi i sigurimit dhe ruajtjes së objektit” të lidhur midis Drejtorisë Rajonale të AKU, Qarku Durrës.

-Arkëtimin e shumës **6 032 lekë** nga shoqëria [REDAKTUAR] paguar me tepër për kontratën Nr. [REDAKTUAR], datë [REDAKTUAR] “Shërbimi i sigurimit dhe ruajtjes së objektit” të lidhur nga Drejtoria Rajonale AKU Durrës.

-Arkëtimin e shumës **13 271 lekë** nga shoqëria [REDAKTUAR] paguar me tepër për kontratën shtesë Nr. [REDAKTUAR], datë [REDAKTUAR] “ Shërbimi i sigurimit dhe ruajtjes së objektit” të lidhur me AKU.

-Arkëtimin e shumës **7 394 lekë** nga subjekti [REDAKTUAR], paguar me tepër për kontratën Nr. [REDAKTUAR], datë [REDAKTUAR] “Shërbimi i sigurimit dhe ruajtjes së objektit” të lidhur me Drejtorinë Rajonale AKU Korçë.

-Arkëtimin e shumës **10 548 lekë** nga subjekti [REDAKTUAR] sh.p.k, paguar me tepër për kontratën e shërbimit shtesë Nr. [REDAKTUAR], datë [REDAKTUAR] “ Shërbimi i sigurimit dhe ruajtjes së objektit” të lidhur me AKU .

-Arkëtimin e shumës **20 064 lekë** nga shoqëria [REDAKTUAR], paguar me tepër për kontratën Nr. [REDAKTUAR], datë [REDAKTUAR] “Shërbimi i sigurimit dhe ruajtjes së objektit” të lidhur me Drejtorinë Rajonale AKU Durrës .

-Arkëtimin e shumës **28 999 lekë**, nga shoqëria [REDAKTUAR], që përfaqëson vlerën e garancisë së ofertës fituese, pasi është tërhequr nga lidhja e kontratës si firmë e shpallur fituese nga Drejtoria Rajonale AKU Durrës.

-Arkëtimin e shumës **47 250 lekë** nga subjekti [REDAKTUAR] që përfaqëson diferencën e rezultuar nga vlera e rillogaritur e çmimit të karburantit në baze të VKM Nr. 822, datë 18.06.2008, paguar më tepër.

(mbajtur procesverbalet nr. 250/1, datë 14.02.2014, nr. 252/1, datë 14.02.2014 dhe nr.251/1 , datë 14.02.2014)

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE

I. Mbështetur në nenin 20 të Aktit Normativ nr.4, datë 16.8.2012 ku përcaktohen procedurat që zbatohen në rastet e moszbatimit të kërkesave të këtij akti në të cilin theksohet: “Moszbatimi i detyrave të parashikuara në këtë akt normativ nga secili prej punonjësve të caktuar në strukturat përgjegjëse, konsiderohet shkelje e rëndë disiplinore dhe sjell fillimin e ecurisë disiplinore për nëpunësin e ngarkuar dhe drejtuesin e strukturës përgjegjëse, në rast se ky i fundit nuk vepron për të siguruar zbatimin e aktit normative”, *Mbështetur në ligjin nr. 7961, datë 12.07.21995 "Kodi i Punës i RSH", neni 37, i ndryshuar si dhe në kontratën individuale të punës, i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të AKU, nisjen e procedurave për marrjen e masave disiplinore “ Vërejtje me paralajmërim ” për :*

1. [REDAKTUAR] me detyrë Drejtor i DRAKU – Lezhë,
2. [REDAKTUAR] me detyrë Inspektor në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë me Origjinë Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit Lezhë
3. [REDAKTUAR] me detyrë Inspektor në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë me Origjinë Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit në DRAKU Lezhë
4. [REDAKTUAR] me detyrë Inspektor në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë me Origjinë Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit në DRAKU Lezhë
5. [REDAKTUAR] me detyrë Inspektor në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë me Origjinë Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit në DRAKU Lezhë
6. [REDAKTUAR] me detyrë Inspektor në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë me Origjinë Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit në DRAKU Lezhë

Për mangësitë gjatë procesit të inspektimit dhe raportimit si më poshtë vijon:

- Nuk kanë mbajtur aktet përkatëse (si cek listë, akt inspektimi, etj) në shumicën e rasteve të inspektimit dhe në rastet e mbajtura nuk janë në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

- Nuk kanë hedhur të dhënat konform inspektimeve të kryera në sistemin AKU net, në kundërshtim me urdhrin e titullarit të AKU .

- Nuk kanë zbatuar aktin normativ në rastet e inspektimit të subjekteve që tregtojnë mish , pasi gjatë inspektimeve të kryera në zbatim të aktit normativ për muajin Dhjetor 2013 , u konstatua se nga 41 subjekte të inspektuara vetëm 6 subjekte ishin me QKR të tjerat 35 subjekte ishin (referuar citimeve në procesverbal) pa dokumentin e kontrollit të mishit (mishi i pa certifikuar dhe pa vulën e veterinerit) ndërkohë vendimi i inspektoreve të inspektimit nuk ka në përmbajtje të tij sekuestrim malli dhe vendosjen e gjobave sipas parashikimeve në nenin 10 dhe nenit 16 të aktit normativ , (mbajtur procesverbali me nr. protokollit 635 datë 13.02.2014).

Shënim: Për [REDAKTUAR], me detyrë Inspektor në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë me Origjinë Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, nuk propozojmë marrjen e masave disiplinore për arsyen, se ky inspektor paraqitet i larguar nga puna në muajin Dhjetor 2013.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT